



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



THIRRJE PËR APLIKIM

Drejtoria për Bujqësi

Ftohen të gjitha shoqatat të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në Sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural e të cilat veprimtarinë e tyre e realizojnë në territorin e Komunës së Prishtinës, se mund të aplikojnë për subvencionimin e tyre.

Kriteret:

- 1.Përkrahja e shoqatave për ngritjen e kapaciteteve profesionale përmes trajnimeve si edhe marrjen e përvojave në fushat përkatëse përmes vizitave studimore,
- 2.Përkrahja për hartimin e dokumenteve të nevojshme si edhe Strategjive zhvillimore të shoqatave,
- 3.Përkrahja financiare e shoqatave për aktivitetet e realizuara në fushat përkatëse si p.sh.organizimi i seminareve, punëtori, trajnime, vizita, e të ngjashme.
- 4.Shoqatat janë të obliguar që të ofrojnë raport financiar për të gjitha shpenzimet e bëra për realizimin e aktiviteteve të tyre .
- 5.Raporti financiar duhet të përmbajë – shpenzimet e bëra sipas aktiviteteve të realizuara, numrin e pjesëmarrësve të nënshkruar nga ana e tyre, faturat dhe kuponat fiskal për shpenzimet e bëra, trajnuesit si edhe shpenzimet tjera logjistike (salla, materiali shpenzues, pajisjet etj.)
- 6.Rimbursimi i mjeteve për shoqata bëhet pas shqyrtimit të raportit financiar nga ana e organit përkatës dhe pas konstatimit se janë realizuar të gjitha aktivitetet dhe shërbimet e parapara.

Dokumentet e bashkangjitura

- Dëshmia e regjistrimit si OJQ-Licenca,
- Kopja e dokumentit identifikues i personit të autorizuar,
- Konfirmimi i llogarisë bankare të Shoqatës,
- Përshkrimi i aktivitetit të Shoqatës
- Referenca e trajnuesve si edhe ekspertëve për shërbimet e kryera

Data e aplikimit prej 15.05.2018 deri më 04.06.2018